- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij

ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

Vula

## **Shtojca 8**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti përgjegjës), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në nenin 42 të Aktit normativ nr.9/2019.
- Personi/at në cilësinë e **anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik**, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019<sup>2</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

<sup>2</sup> Autorizoj Autoritetin Përgjegjës të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

**Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula \_\_\_\_\_**

## Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 11

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik* ]

### DEKLARATË MBI NDËRTIMET CIVILE DHE INDUSTRIALE<sup>3</sup>

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Përgjegjës \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Operatori ekonomik \_\_\_\_\_, nuk është subjekt i ndërtimeve civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, ndërtuara, të mbikëqyrura dhe/ose të kolaudura, të dëmtura nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

Personi/at në cilësinë e aksionarit, oraktu, administratorit dhe ose anëtarët e një organi administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësi i tij aksionar ose ortak duhet të deklarojnë se nuk kanë pasur kompetenca vendimarrëse në një shoqëri, ku ndërtimet civile civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, të ndërtuara, të mbikëqyrura dhe/ose të kolaudura, nga kjo e fundit janë të dëmtuara nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

.  
.

**Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

---

<sup>3</sup> Akti normativ nr.9, date 16.12.2019 “Për përvallimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” neni 42, pika 5 shkronja ë).

**Shtojca 12**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> <b>Punë:</b>		
Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____



## **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.**

**Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, seicili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.**

**Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht<sup>4</sup>;
- b. Prokura e posaçme.

---

<sup>4</sup> Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të seicilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
  - b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;
  - c. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;
  - ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
  - d. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;
  - dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 10;
  - e. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas shtojcës 11.
- ë. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti përgjegjës),

### 2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9

### 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet te mos jete me e vogel se 30 % e fondit limit te procedures qe prokurohet. *Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.*

**2.2.2** Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate tre viteve te fundit 2017, 2018, 2019. *Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të tre viteve të fundi, të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet, **ne te cilat duhet te rezultojë se nuk ka dale me humbje te pakten ne dy vite te njepasnjeshem.***

Te gjitha subjektet qe i nenshtrohen përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, duhet te paraqesin bilancet e te tre viteve te fundit te aktivitetit (2017, 2018, 2019), te audituara nga ekspertet kontabel te licensuar,

*Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre.*

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet te paraqese një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vërtetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar aktivitet per vitin 2019,

sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, për çdo adresë ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet, sipas QKB.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësia Administrative ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR).

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa ”a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.**

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

2.3.1 Kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet me vlerë jo më të vogël se 30 % e fondit limit, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, si dëshmi të paraqitet Kopje e kontratës së nënshkruar me ent publik, dhe Faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimi i realizuar;
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi të paraqiten: Kopje e kontratës së nënshkruar si dhe faturat tatimore përkatëse të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet/ punët e realizuara).

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licenca profesionale për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, sipas kategorive të mëposhtme:

**Kat 1 – c** Plane të detajuara vendore.

**Kat 2 – a,c, d** a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale – objekte turistike. c- Projektim interiere. d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

**Kat 3 – a,b-1, c-1.2, d,** a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate , b-1 Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate.c-1 Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme - metalike. d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

**Kat 4 – a,b,c,e,f,h,j** a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare. b- Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme. c-Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. e-Projektim të sistemeve të furnizimit me gaz. f-Projektim të sistemeve kundra zjarrit. h-Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.) j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj, për objektet civile e industriale.

**Kat 5 – b,c** b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi. c- Ujësjellës-kanalizime urbane – rurale.

**Kat 8 – a,b,c,d,e** a- Rivelimë inxhinierike. b- Rilevime inxhinierike kadastrale. c- Sisteme GIS. d- Bazamente gjeodezike. e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

**Kat 9 – a, b,d,e** a- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trullit për objekte civile –

- Ekonomike deri 5 kate. b- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate. d- Studim/vlerësim gjeologo -inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët. e- Studime e projektme hidrogeologjike.

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.***

2.3.2 Si dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se ka mesatarisht të siguruar, jo më pak se 45 punonjës me kohe te plote për periudhën Janar 2020–Gusht 2020.

Kjo e vërtetuar me: *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar, shoqeruar me formularët E-SIG të konfirmuara nga organet perkatëse (me nënshkrim elektronik ose ne hard copy).*

2.3.3 Operatori Ekonomik për kryerjen e shërbimeve, duhet të paraqesë një liste të personelit kryesor, i cili duhet të jetë i liçensuar në shërbimet e projektimit dhe duhet të zotërojë liçensat profesionale sipas kategorive të renditura me minimalisht:

Lloji	Vite eksperience	Certifikime/Diploma	Kategoria e licenses
2 Arkitekt	25	Te pakten njeri te jete I pajisur me deshmi kualifikimi ne Arkitekture, leshuar nga Institucione Shteterore perkatëse si dhe Certificate ne mbrojtjen e programit Auto Cad.	1/c 2/a, c, d
2 Inxhinier Ndertimi	15	Te pakten njeri te jete i pajisur me i pajisur me certificate vlersimi pasurive te paluajtshme dhe diplome ne mbrojtjen e programit Auto Cad.	3/a,b,d 4/a
Inxhinier Elektrik	15		4/c/j
Inxhinier Gjeodet	15		8/a,b,c,d,e
Inxhinier Gjeolog	15	Deshmi specializimi ne fushen e gjeologjise inxhinierike, hidrogeologjike dhe	9/a,b,d,e

		gjeomjedisit leshuar nga institucione shteterore perkatese.	
Inxhinier Hidroteknik	15		1/c 3/abcd 4/af 5/b
Inxhinier Mekanik	15		4/a,b,e,f,h

*Per secilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme, diplome dhe CV perkatese, dokumentacionin qe verteton kualifikimet e siperkerkuara, te figurojne ne Licensen e Shoqerise, si dhe te figurojne ne listepagesen e shoqerise per periudhen Janar 2019 – Gusht 2020. Pikat e licensen se kerkuara per secilin prej anetareve te stafit kerkohen individuale te pakten nga njeri prej anetareve*

### **Stafi ndihmës për shërbimin e projektimit**

- 2 Arkitekt
- 1 Inxhinier Hidroteknik
- 1 Inxhinier Ndertimi
- 1 Inxhinier Topograf
- 1 Inxhinier Mjedisi
- 1 Inxhinier Elektrik
- 1 Inxhinier Mekanik
- 1 Inxhinier IT

Per stafin mbeshtetes te paraqiten kontratat e punes, diplome, cv, libreze pune si dhe te figurojne ne listepagesen e shoqerise per periudhen Janar 2020 – Gusht 2020.

2.3.4 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin e Projektit të, I cili duhet të jete projektues Arkitekt, duhet të jetë i perfshire ne licensen e shoqerise, të jetë pjesë e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Janar 2020 – Gusht 2020.

2.3.5 I gjithë Stafi I kerkuar te jete i siguruar sipas legjislacionit ne fuqi dhe nuk duhet te jete I angazhuar ne kontrata te tjera projektimi, ne proces, te shpallura fitues apo lidhur kontrate. Kjo kerkese vjen, nisur nga koha e shkurter per realizimin e sherbimit ne fjale, dhe rendesise prioritare qe u eshte dhene objekteve te rindertimit, me ane te akteve nenligjore perkatese te hartuara per kete qellim. (deklarate nga administratori I shoqerise).

2.3.6 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera instrumentat topografike si me poshte:

- 1 (një) Pajisje GPS
- 1 (një) Pajisje Total Station

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Fatura Tatimore shitblerje ose Kontratë Qeraje të noterizuar si dhe dokumentat e pronesisë së qiradhënësit (origjinal ose fotokopje e noterizuar).

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga kryqi i kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.
- 2 (dy) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.

**Për secilin duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale të punës
- Diploma/certifikata

Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhen Janar 2020 – Gusht 2020

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë çertifikatat të vlefshme si me poshte:

Operatori Ekonomik duhet të zoterojë dhe të paraqesë një çertifikate ISO 9001-2015 të vlefshme ose ekuivalente për sistem menaxherial të cilësisë

Operatori Ekonomik duhet të zoterojë dhe të paraqesë një çertifikate ISO 14001-2015 të vlefshme ose ekuivalente për sistem menaxherial të mjedisit.

Operatori Ekonomik duhet të zoterojë dhe të paraqesë një çertifikate ISO 18001-2007 të vlefshme ose ekuivalente për sistem menaxherial të shëndetit dhe sigurisë në punë ose ekuivalente.

Operatori Ekonomik duhet të zoterojë dhe të paraqesë një çertifikate PASS 99-2012 të vlefshme ose ekuivalente për sistem të menaxhimit të integruar.

Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike kushti i mesiperme duhet të plotësohet nga secili prej anetareve të bashkepunimit.

**\* Te gjitha certifikata e mesiperme duhet të jenë të lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.9 Kandidati/ ofertuesi për realizimin e kontratës duhet të disponojë 2 (dy) mjete transporti të specialistëve. Për të veretuar këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik. Për të dëshmuar këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat e mëposhteme:

1. Për mjetet ne pronesi qe shenohen ne Regjistrat publike, duhet te paraqiten dokumentat qe vertetojne rregjistrimin e mjetit si: Leje Qarkullimi, Siguracionin e mjetit dhe Certifikatën e Kontrollit teknik.
2. Për mjete e marra me qera dokumentave te mesiperm ti bashkëlidhen Kontrata perkatese te qerese / leasing / huaperdorjes, në emër të objektit, të jenë të lidhura para noterit dhe afati i të cilave të perfshijë periudhën e ndërtimit të objektit.

*Per nevoja te levizjes se stafit dhe pavarsia e transportit nga ai publik i cili eshte me orare te percaktuar ky sherbim te sigurohet nga operatori ekonomik qe ne fillim te procedures*

*Autoriteti përgjegjës mund të përcaktojë kriteret kualifikimi sipas natyrës dhe objektit të prokurimit duke pasur respektuar kuadrin regullator të rindërtimit dhe LPP.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## **Shtojca 14**

*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Përgjegjës]*

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:



## **Shtojca 15**

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]*

### **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: “Hartimin e projektit të nderhyrjeve rehabilituese/ pershatese të nevojshme për kthimin e struktureve të objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore në bashkinë Lezhë”.

Afatet e ekzekutimit: 3 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

## **Shtojca 16**

( *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës*)

### **TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

## Shtojca 17

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

### NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Aktin Normativ nr.9, datë16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Përgjegjës ka shkelur Aktin Normativ gjatë procedurës së prokurimit publik për rindërtimin, atëherë keni të drejtë të ankoheni siç parashikohet në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< Emri >

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

## Shtojca 18

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Etj.

\* \* \*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NUIS-it*  
Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NUIS-it*

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NUIS-it

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NUIS-it

Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me \_\_\_\_\_ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*].

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[**Titullari i autoritetit përgjegjës**]

## Shtojca 19

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit përgjegjës]**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES**  
**Shërbimet**

**Neni 1 Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2 Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Përgjegjës” do të thotë Autoriteti Përgjegjës që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.



- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3 Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikrat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## **Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.
